



РЕПУБЛИКА СЕВЕРНА МАКЕДОНИЈА
REPUBLIKA E MAQEDONISË SË VERIUT

Бр./Nr _____

_____ г./в.



Në bazë të nenit 22 paragrafi 1 nga Ligji për parandalimin e korrupsionit dhe konfliktit të interesave ("Gazeta zyrtare e Republikës së Maqedonisë " Nr. 12/2019) neni 40 paragrafi 2 nga Rregullorja për punë të Komisionit Shtetërorë për Parandalimin e Korrupsionit, duke vepruar sipas denoncimit të parashtruar nga parashtrues i panjohur KSHPK (në tekstin e mëtejshëm) në seancën e 85-të, të mbajtur më 12.04.2023, morri vendimin vijues:

VENDIM

Denoncimi I regjistruar me numër 12-3902/1 të datës 15.08.2019, me pretendime për parregullsi në procedurën e punësimit të më shumë realizuesve në /// gjatë vitit 2018, HIDHET POSHT.

KSHPK-ja konstatoi se në përputhje me dispozitat e ligjit për parandalimin e korrupsionit dhe konfliktit të interesave nuk ka elemente për veprim kompetent për arsye se në denoncimin e dërguar nuk ka pretendime të qarta për veprime të paligjshme dhe të palejueshme të personave zyrtar gjat kryerjes së autorizime publike dhe detyrës zyrtare, për të cilën pretendimet e paraqitura nuk japin bazë për të marrë veprime nga ana e KSHPK-së në përputhje me kompetencat e saj ligjore.

Lënda me numër 12-3902/1 të datës 15.08.2019 të mbyllet dhe të arkivohet.

Vendimi i KSHPK-së në formë të depersonalizuar të publikohet në veb faqen e KSHPK-së në afat prej 5 (pes) ditëve nga dita e miratimit.

Arsyetim

Më 15 gusht 2019, një parashtrues i panjohur ka bërë denoncim me pretendime për parregullsi në procedurën e punësimit të disa realizuesve /// gjatë vitit 2018 dhe është formuar lënda me numër 12-3902/1, datë 15 gusht 2019.

Në denoncim, parashtruesi, pa treguar veprime konkrete të personave të caktuar, paraqet disa vërejtje në lidhje me procedurën e zhvilluar pas shpalljes, të cilat i referohen periudhës në të cilën është kryer përzgjedhja, përzgjedhjes së kandidatëve kundrejt renditjes së përcaktuar dhe renditjes dhe procedurën e njoftimit të kandidatëve të papërzgjedhur.

